

## Kategoria Superiore / Fitojne Partizani dhe Tirana, te tjerët harrojnë të shënojnë

nga Mario Nikolli

E hënë, 15 Shtator 2014 00:05

---

Skuadra e Partizanit ka fituar ne Kukes nje takim shume te rendesishem duke marre tre pike te vlefshme. Racic ka ekzekutuar mjeshterisht nje goditje denimi per skuadren e tij ne minutat e fundit te takimit. Me kete trepikesh skuadra e Shpetim Duros ngjitet ne vendin e dyte ne barazpeshe pikesh me Skenderbeun, Kukesin e Flamurtarin

Fitore me vlera ka arritur edhe skuadra e Tiranës ne kryeqytet. Bardheblute kane mundur skuadren e Elbasanit me rezultatin e ngushte 2-1. Mbrojtësi i kombetares Debatik Curri ka realizuar ne minutat e fundit shtese te takimit duke i dhene



Tiranës kryesimin e kampionatit.

Ne takimet e tjera nuk ka pasur gola te shenuar.

TEUTA-LAÇI 0-0

Gjyqtarë: K.Meta, R.Avdo, D.Rexha

APOLONIA-SKENDERBEU 0-0

Gjyqtarë: B.Ziri, E.Veseli, Sh.Ziri

TIRANA-ELBASANI 2-1

Golat: Bushic 11', Curri 90+2' / Kaculi 45'

Gjyqtarë: K.Kola, R.Cokaj, R.Malaj

FLAMURTARI-VLLAZNIA 0-0

Gjyqtarë: K.Cjapi, I.Tartari, O.Grabova

nga Mario Nikolli  
E hënë, 15 Shtator 2014 00:05

---

**KUKESI-PARTIZANI 0-1**

Goli: Racic 88'

Gjyqtarë: L.Jemini, G.Qirici, E.Barushi